



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 935/ prot.

Tiranë, më 02.12.2019

Lënda: Në përgjigje Tuaj nr.4329/1 prot. dt. 22.11.2019 dhe nr.4468/1 prot.dt.02.12.2019.

INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

E nderuar Znj.Zonja,

Nisur nga informacioni i kërkuar nga Ju në shkresat e lartëpërmendur, sqarojmë si më poshtë:

Së pari: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) më datë 15.11.2019, ka publikuar në Faqen Zyrtare të tij, listën e kandidatëve prokurorë, të cilët plotësojnë kushtet ligjore për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (KED) për vitin 2020 si dhe listën e kandidatëve që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore në këtë proces.

Së dyti: Kandidatët të cilët nuk plotësonin kushtet dhe kriteret ligjore për tu zgjedhur anëtarë të KED-së, bazuar në nenin 221 pika 5, të Ligjit nr.115/2016, datë 03.11.2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", janë njoftuar individualisht lidhur me këtë vendim, konkretisht;

- Znj. Irma Balliu me shkresën nr.934 prot. dt.22.11.2019
- Z. Arqilea Koça me shkresën nr.932 prot. dt.22.11.2019
- Z. Elvin Gjokaj me shkresën nr.933 prot. dt.22.11.2019
- Z. Artan Bajrami me shkresën nr.929 prot. dt.22.11.2019
- Z. Alfred Agolli me shkresën nr.928 prot. dt.22.11.2019
- Z. Ferdinand Elezi me shkresën nr.927 prot. dt.22.11.2019

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Qemal Stafa" Nr. 1, godina e Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë

www.klp.al/ adresa e mail; info@klp.al

Aktualisht nuk kemi asnjë informacion apo njoftim zyrtar, për depozitim të ankimit lidhur me këtë vendim nga kandidatët e skualifikuar, pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Së treti: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) në hartimin e listës me kandidatët për tu zgjedhur anëtarë të KED-së, ka vlerësuar sipas përcaktimeve ligjore të nenin 221, të Ligjit nr.115/2016, datë 03.11.2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ku ndër të tjera thuhet se:

1. Mund të përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vetëm ata magistratë dhe gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët, në momentin e organizimit të shortit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) në kohën e hedhjes së shortit magistrati e ka ushtruar funksionin për të paktën 10 vjet dhe anëtari i Gjykatës Kushtetuese për të paktën 1 vit;

b) nuk ka një masë disiplinore në fuqi;

c) nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit;

ç) magistrati ka përfunduar ciklin e plotë katër ose pesëvjeçar të studimeve në drejtësi;

d) magistrati ka përfunduar Shkollën e Magistraturës;

dh) magistrati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit etik dhe profesional;

e) magistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është nën hetim ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;

ë) magistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesave.

Ligji nr.115/2016 ka pësuar disa ndryshime me ligjin nr. 47/2019, datë 18.07.2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Ky ligj ka shfuqizuar disa kritere të Ligjit nr.115/2016, konkretisht:

ç) magistrati ka përfunduar ciklin e plotë katër ose pesëvjeçar të studimeve në drejtësi;

d) magistrati ka përfunduar Shkollën e Magistraturës;

Procedura e ndjekur nga KLP-ja për këtë proces, është bazuar në zbatim të dispozitave të sipërpërmendura, ndaj dhe lista e kandidatëve të propozuar për vitin 2020 është më e zgjeruar dhe

këta kandidatë për tu zgjedhur anëtarë të KED-së plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në ligj.

Ju faleminderit për mirëkuptimin,



Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Qemal Stafa" Nr. 1, godina e Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë

www.klp.al/ adresa e mail; info@klp.al